

## **Raport individual i konsultimit publik, për projektligjin:**

### **“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar”**

#### **1. Titulli i projekt aktit**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar”.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar” ka për qëllim përmirësimin e veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve në ndihmë dhe mbështetje të funksioneve të saj ligjore. Synimi i këtij projektligji është të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme aftësitë dhe kapacitetin e avokatëve të shtetit. Nëpërmjet këtij projektligji synohet gjithashtu, zgjerimi i kompetencave të Avokaturës së Shtetit në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave pasurore të organeve të pushtetit vendor.

Miratimi i këtij projektligji do të kontribuojë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë në ushtrimin e funksioneve të avokatëve të shtetit, garantimin e qëndrueshmërisë së profesionistëve, si dhe ofrimin e një përfaqësimi dhe mbrojtjeje të specializuar për pushtetin vendor. Nëpërmjet këtij projektligji synohet të zgjidhen pengesat e krijuara për rekrutimin e avokatëve të shtetit, duke parashikuar mënyra rekrutimi me kritere të forta dhe me procedurë më të shpejtë.

Projektligji parashikon:

1. Saktësimin e disa termave të përdorur në ligj, si dhe përcaktimin e natyrës së marrëdhënieve të punës për ndihmësit ligjor të avokatëve të shtetit;
2. Përfaqësimin dhe mbrojtjen nga Avokatura e Shtetit e interesave pasurore të organeve të vetëqeverisjes vendore përpara gjykatave të të gjitha niveleve, në çështjet gjyqësore në të cilat këto organe janë palë;
3. Shtimin e dy kritereve të reja për t’u emëruar avokatë shteti si përjashtuese në raport me kushtin për të përfunduar programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës;
4. Caktimin nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit i një ose disa avokatëve të shtetit pranë misionit të përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Evropës, si përfaqësues të përhershëm dhe që veprojnë në emër të tij, pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

5. Funkcionin e ndihmësit ligjorë të avokatëve të shtetit në nivel qendror dhe vendor, përcaktimin e kriterëve të emërimit dhe pagën në koherencë me piramidën e pagave dhe nivelin e ndihmësve ligjore që synohet të rekrutohen pranë Avokaturës së Shtetit.

## 2. Kohëzgjatja e konsultimeve

*Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.*

Projektligji iu nënshtrua procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, për një periudhë prej 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë 19.5.2026 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJKP, ku të gjitha palët e interesuara:

- organet publike;
- shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
- personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe
- personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë,

ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: [merita.bundo@kryeministria.al](mailto:merita.bundo@kryeministria.al)

Data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte 17.6.2026.

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 247 shikime në platformën online, por nuk janë regjistruar komente në RENJKP.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar” si dhe relacioni përkatës u publikuan në linkun, [www.konsultimipublik.gov.al](http://www.konsultimipublik.gov.al).

## 3. Metodatat e konsultimit

*Listoni të gjitha metodatat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.),*

*Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).*

Metoda e konsultimit, e përdorur për këtë projektligj, ishte:

1. Publikimi në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP)

#### **4. Palët e interesit të përfshira**

*Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.*

*Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.*

*Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.*

Nuk rezultoi të ketë patur palë të interesuara (organizata të shoqërisë civile, subjekte private apo individë), të përfshira në procesin e konsultimit publik të projektaktit.

#### **5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara**

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;*

*Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;*

*Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

Nuk pati komente apo sugjerime lidhur me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar”, të publikuar në RENJK.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në	Vendimi (I pranuar/I pranuar	Justifikimi

e..., rregullimi i..., etj.)	palët e ndryshme të interesuara së bashku)	mënyrë të ngjashme)	pjesërisht/I refuzuar)	
---------------------------------	--	------------------------	---------------------------	--